VENDIM
Nr. 557, datë 15.7.2026

PËR HAPJEN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DUBLIN, REPUBLIKA E IRLANDËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 24/2026, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Dublin, Republika e Irlandës.
2. Shpenzimet për hapjen e kësaj ambasade përballohen nga buxheti i vitit 2026 i miratuar në programin "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit" dhe zëri "Shpenzime korrente" për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama